



Tiranë 10/11/2014

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET

970 Prof. KMD

QENDRES MJEDISORE “RECYCLE ALBANIA” (organizatë jo-fitimprurëse) e themeluar sipas legjislacionit civil shqiptar krijuar me Vendimin Nr.783, datë 10.1.2013 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, identifikuar me NIPT L32320452S, me seli : Rruga Sami Frashëri, Pallati Mjelma, përfaqësuar nga Zj. Albjona Mino, me cilesine Drejtuese Ekzekutive, i cili është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

DHE

KOMISIONERIT TE MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI (referuar si KMD), përfaqësuar nga Z. Ymer Baraku, me cilesine Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili është autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi. Qendra Mjedisore “Recycle Albania” dhe “KMD” (këtej e tutje të quajtura Palët), deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të bien dakort përsa më poshtë:

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

Në bazë të ligjit 10463, datë 22.9.2011 dhe direktivës 2006/12/CE të Parlamentit European mbi mbetjet e rrezikshme me afat të gjatë dekompozimi, “Recycle Albania” mundëson promovimin dhe ndermjetsimin me kompanite ricikluese per riciklimin e mbetjeve të elektronike si , kompjutera, printera, fotokopje, kartucat e tyre te perdorura etj. Qëllimi kufizimi dhe ndalimi i hedhjes se ketyre lloj mbetjesh bashke me mbetjet e zakonshme urbane, sic ligji parashikon.

Qendra “Recycle Albania” merr përsipër ne bashkpunim me kompanite e riciklimit, të tërheqë pa pagesë, mbetjet elektronike të përcaktuara më sipër nga ambientet e institucionit . Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë për mbarëvajtjen e procesit të administrimit dhe evadimit te mbetjeve.

Neni 2
Mënyra e bashkëpunimit

“Recycle Albania”, do të vendosë _____ kuti Eco Box në të cilat të hidhen mbetjet jo voluminoze si p.sh kartucat e bojrave të printerave e fotokopjeve.

Tërheqja e këtyre mbetjeve elektonike bëhet mesatarisht me një frekuencë kohore prej një here ne muaj.

Për mbetjet elektronike me përmasa të mëdha si p.sh kompjutera, printera, fotokopje, ups, terheqja behet ne cdo disa muaj ose me kerkese te institucionit qe kerkon ti ricikloj keto mbetje.

Rruga: Sami Frasheri, Pal. Mjelma, Kati 7, Ap 32, Tirane-Shqiperi, 10010

Cel: 067 40 15241 Tel. 046-303374

E-mail: info@recyclealbania.org

<http://www.recyclealbania.org>





Neni 3 **Zbatimi i marrëveshjes**

Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj marrëveshje nga data e nënshkrimit të saj dhe do të përpiqen ti zgjidhin me mirëkuptim të gjithë mosmarrëveshjet që mund të rrjedhin gjatë zbatimit.

Neni 4 **Koordinimi ndërmjet palëve**

Secila palë do të caktojë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore, email dhe telefon.

Neni 5 **Hyrja në fuqi, vlefshmëria**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
Kjo marrëveshje është e vlefshme derisa palët nuk kanë kërkuar shfuqizimin e saj.
Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë dispozitë e saj, nuk është në tejkalim ose kundërshtim të akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore, mbi të cilat palët ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
Kjo marrëveshje përfundon nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim nga secila palë, jo më parë se 2 muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

Hartuar në Tiranë, më datë 10/11/2014 në 4 (kater) kopje origjinale.

PËR QENDRËN MJEDISORE “RECYCLE ALBANIA”

DREJTUESE EKZEKUTIVE:

ALBJONA MINO

PËR KOMISIONERIN E MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI

PERFAQESUESI I INSTITUCIONIT:

Ilir Beqiri

